



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇES VERBAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK

MBI

DRAFT RREGULLORET “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË TITUVJE VENDORË TË NDERIT DHE VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : Me ekspertë, grupe interesi dhe komisionin ad hoc për hartimin e këtyre rregulloreve.

Data : 23.01.2024 **Ora :** 12:00 **Vendi:** Salla e mbledhjeve të Këshillit bashkiak.

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë, ekspertë të fushës dhe grupe interesi. (Bashkangjitur listë prezencë).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e takimit konsultativ
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Takimi hapet nga kryetari i këshillit Bashkiak **Z.Luli**, i cili prezanton shkurtimisht temën e këtij takimi duke ia dhënë fjalën më pas kryetares së komisionit ad hoc të ngritur për hartimin e dy pr/rregulloreve Znj.Uarda Gjekaj, e cila thekson faktin se të gjithë anëtarët e komisionit në fjalë kanë qënë prezent dhe bashkëpunues.

Fjalën e merr **Z.Anamali**, i cili bën një sqarim lidhur me termin e paraqitur në rregullore “Titull i veçantë vendor nderi”, ardhur ky si propozim nga ana e tij. Këtu ai nënkupton p.sh “Shoqërinë Vllaznia”, përfshirë këtu edhe personalitete që kanë dhënë kontribut të veçantë

për Bashkinë e Shkodrës, sepse ligji shton ai shprehet se titulli duhet të lidhet me edhe me datën e ngjarjes.

Z.Luli propozon që në rregulloret përfundimtare duhet të jetë e shprehur qartësisht që nuk mund të nderohen me titull, persona që kanë qenë bashkëpunëtorë të ish-sigurimit të shtetit. Gjithashtu ai propozon që si titull nderi të përdoret termi “Krenaria e Qytetit”.

Vijohet me diskutime mbi emërtesën për tituj nderi. Sekretari i Këshillit **Z.Lesha** propozon që kjo të lihet e hapur, sipas rastit që do paraqitet.

Përsëri e merr fjalën **Znj.Gjekaj**, e cila ndalet tek neni 14 i Pr/Rregullores për titujt e nderit, tek konfidencialiteti i procedurës. Ajo shprehet se komisioni duhet të ruaj konfidencialitetin e propozimeve të paraqitura dhe që s’kualifikohen.

Z.Luli kërkon të dijë nëse është menduar mbi certifikatën që do jepet dhe për ceremoninë e nderimit të personave që nderohen me titull nderi?

Përgjigjet **Znj.Gjekaj** dhe thotë se kjo do mbetet në dorë të komisionit të përhershëm për këtë çështje. Pjesë kjo që paraqitet në nenin 16, të Pr/rregullores, në dipozitat tranzitore.

Përsëri **Z.Luli** propozon që në rregullore duhet përfshirë dhe saktësuar modeli tip i certifikatës, kush do nënshkruaj, mënyrën e ceremonisë së nderimit etj.

Kalohet tek Draft Rregullorja tjetër: Emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Shkodër.

Pas diskutimeve me anëtarët e tjerë të komisionit dhe specialistëve të Bashkisë, propozohet të hiqet pika e, neni 5 kësaj pr/rregulloreje. Po ashtu kërkohet që të specifikohet edhe pika d, e këtij neni duke sqaruar saktësisht definicionin se çfarë do të thotë komunitet, organizatë, biznes etj. Gjithashtu të plotësohet me bazë ligjore edhe neni 1. i rregullores.


Z.Luli përsëri kërkon që tek neni 6 pika 12 të shtohet edhe fjala kontribues në fushën e sportit.

Kurse **Z.Shkjau** propozon që kërkesat e paraqitura, të mos jenë vetëm me nënshkrimin e personave propozues por me akt noterial (neni 7, pika 2)

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Dëgjesa për pr/rregulloret deklarohet e mbyllur.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



SEKRETAR



Denis LESHA

TAKIMI KONSULTATIV MI DRAFT RREGULLORET "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË TITULJE VENDORË TË
 NDERIT DHE VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE
 NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË SHKODËR

LISTE PREZENCE

Nr.	Emri Mbiemri	ESHATI	Kontakti	e-mail	Firma
1	EDMOND Hoxha	SHKODER	0694028418	edmon.hoxha@shkoder.org	
2	Arbush Topaj	SHKODER	0692595781	a-topaj@shkoder.com	
3	Ymeri Merhi	SHKODER	0692402185		
4	Besmir Nohli	SHKODER	692404375		
5	Donika Uthaj	SHKODER	688803188		
6	Arben Shalji	SHKODER	0676003026		
7	Arta Praga	SHKODER	0685324024		
8	Edmond Lomo	SHKODER	0696770998		
9	Jonida Shalji	SHKODER	0694055992		